

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË



REZYME E DISERTACIONIT TË DOKTORATËS

**“SHPËRNGULJA ME DHUNË E SHQIPTARËVE NGA KOSOVA NË
SHQIPËRI GJATË VITEVE 1918-1941”**

MENTOR: PROF. DR. BUJAR DUGOLLI

KANDIDATI: YLLI HASHANI

PRISHTINË, 2023

Fokusi i vendosur përgjatë kësaj përsiatje përfshin trajtimin e shpërnguljes që u është bërë shqiptarëve nga Mbretëria Serbo – Kroate – Sllovene dhe Jugosllavia në mes të dy luftërave botërore. Megjithëse kjo temë është e trajtuar në linja të faktografisë historike, dimensione të rëndësishme të saj kanë mbetur pa u shtjelluar mjaftueshëm nga historiografia shqiptare, duke e lënë këtë kapitull të papërmbyllur në kuptimin e tij të plotë. Prandaj, kjo temë është specifikuar pikërisht me qëllim që ta përafrojë këtë kapitull, rreth të shpërngulurve nga trevat e tyre drejt Shqipërisë, si dhe vendosjen e tyre në rajone të ndryshme në shtetin shqiptar.

Punimi shtron perspektivën historike të raporteve, statusit, rrethanave dhe kontekstit të ngjarjeve politike që e karakterizon këtë periudhë, ku shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera u gjendën përballë forcave okupuese, në mësymjen e të cilëve përqendrohej largimi me dhunë i shqiptarëve nga trojet e veta.

Në këtë kuadër, tema trajton planet politike dhe ushtarake shtetërore të MSKS-së dhe të Jugosllavisë së asaj kohe, si dhe synimet e veprimet strategjike për shpronësimin e shqiptarëve nga trevat etnike dhe vendosjen e kolonëve në këto vise. Në rrjedhë të kësaj qasjeje, punimi i pasqyron edhe përmasat konkrete të manifestimit të dhunës me të cilat shqiptarët u përballën, si faktorë të drejtpërdrejtë që nxitën largimin e tyre me forcë.

Në kapitullin e parë trajton aspekti i faktorëve që kanë ndikuar në shpërnguljen me dhunë të shqiptarëve nga Kosova. Këtu hyjnë si pjesë e këtij kapitulli si akti i parë që ishte ripushtimi i Kosovës në vitin 1918 dhe po ashtu edhe krijimi i Mbretërisë Serbo – Kroate – Sllovene, ku organet e pushtetit filluan menjëherë një politikë antishqiptare. Më pas pasqyrohet edhe qëndresa e popullit shqiptarë ndaj pushtetit serbo – malazez, ku ata ju kundërvyen me rezistencë të armatosur ndaj aplikimit të kësaj politike të njohur vite më parë. Kurse si pjesë e fundit e këtij kapitulli paraqiten edhe disa ndarje administrative territoriale e ushtarake ku përfshijnë ato nga viti 1919 e deri në vitin 1929, ku të gjitha këto ndarje kishin një qëllim atë të thyerjes së kompaktësisë të popullit shqiptarë.

Kapitulli i dytë përfshinë shpërnguljet me dhunë të shqiptarëve nga Kosova në Shqipëri duke filluar nga viti 1918 e deri në vitin 1924. Pra është etapa e parë e të shpërngulurve që trajtohet në këtë studim ku janë bërë hulumtime të veçanta për ta parë veprimet dhe të gjitha mënyrat e dhunës që kanë përdorur qarqet sllave ndaj popullsisë shqiptarë në viset e tyre. Pjesë e këtij kapitulli janë paraqitur shpronësimet e popullsisë shqiptare nga pasuritë e tyre nga organet e pushtetit, e po ashtu edhe fillimi i të ashtuquajturës reformës agrare ku shqiptarëve ju merrej toka në emër të kësaj reformë, e më pastaj e njejta tokë ju jepej kolonëve të ardhur serb e malazez. Këto veprime vinin duke u rritur dita ditës

dhe jeta e shqiptarëve bëhëj e padurushme, pasi që organet e pushteti përdornin çdo mjet të mundëshëm të dhunës për të arritur qëllimin e tyre për shpërnguljen dhe asimilimin e shqiptarëve. Në këtë kapitull padyshim zë një vend të rëndësishëm edhe roli i Komiteti “MKK” që përveq që u bë zëri kryesor i shqiptarëve jashtë kufijevë të shtetit shqiptar, ai dha një kontribut të jashtëzakonshëm në aspektin diplomatik për parandalimin e shpërnguljeve si dhe u organizua mjaftë mirë për të ndërgjegjësuar opinionin dhe faktorët ndërkombëtar të Fuqive të Mëdha për krimet dhe masakrat serbe ndaj shqiptarëve.

Kapitulli i tretë trajton vazhdimin e zbatimit të reformës agrare kolonizuese dhe shpërnguljeve me dhunë e shqiptarëve nga Kosova në Shqipëri gjatë viteve 1925-1929, paqyrimi i kësaj periudhe dhe po ashtu përfshinë sidomos raportet e diplomatëve shqiptar për çështjen e të shpërngulurve nga trojet e tyre si dhe gjendjen në të cilën ndodhesin shqiptarët brenda Mbretërisë SKS.

Kapitulli i katërtë trajton shpërnguljen me dhunë të shqiptarëve nga Kosova në Shqipëri gjatë viteve 1929-1941, përfshinë edhe pjesën e viteve të fundit deri në fillimin e Luftës së Dytë Botërore. Edhe në këtë periudhë intensifikohet edhe më tutje veprimet e dhunës nga aparati shtetëror jugosllav ndaj shqiptarëve për largimin nga vendet e tyre dhe vendosjen e kolonëve sllavë e po ashtu zbatimin e reformës agrare. Sidomos vitet e 30-ta përfshijnë një zhvillim të mëtejshëm të kësaj politike ku u hartuan shumë programe, planë, elaborate e memorandume për shpërnguljen e të gjithë shqiptarëve nga Jugosllavia, e që padyshim dallohej Klubi Kulturor serb e sidomos famëkeqi Vasa Çubrilloviqi e shumë profile të njohura të shkencës, kulturës dhe politikës serbe.

Kurse kapitulli i pestë dhe i fundit përfshinë se qfarë ishte qëndrimi i Shtetit Shqiptar ndaj të shpërngulurve dhe sa arriti të bënte sistemimin e tyre në Shqipëri. Pas gjithë hulumtimeve dhe gjetjeve rreth mënyrës së shpërnguljes së shqiptarëve, në këtë kapitull ia është bërë një trajtim i qëndrimit që shteti shqiptar kishte ndjekur dhe rolin e tij ndaj të shpërngulurve dhe po ashtu mënyrën se si janë sistemuar ata në Shqipëri, në cilat zonat në cilat rajone dhe po ashtu mënyrën e trajtimit dhe që iu janë bërë të shpërngulurve shqiptarë nga viset e tyre për në shtetin amë Shqipërinë. Shteti Shqiptarë për të ju dalë në ndihmë këtyre emigrantëve të ardhur, arriti ta hartoj dhe infrastrukturën ligjore duke miratuar disa ligje në vitet e 20-ta e sidomos Dekretligjin mbi vendosjen e emigrantëve të vitit 1931. Po ashtu në pjesën e fundit të këtij kapitulli përfshihen plotësisht duke u bazuar në dokumentet arkivore, statistikat përgjatë këtyre viteve të të shpërngulurve dhe të instaluarave të shqiptarëve të Kosovës në Shqipëri, nëpër Prefektura dhe rajone të

ndryshme të shtetit shqiptar, dhe po ashtu edhe ndihmat që iu janë dhënë këtyre emigrantëve.

SUMMARY

The focus established throughout this reflection includes the treatment of the displacement of Albanians from the Kingdom of Serbo-Croatian-Slovenian and Yugoslavia between the two World Wars. Although this topic is treated along the lines of historical factography, important dimensions of it have not been sufficiently elaborated by Albanian historiography, leaving this chapter unfinished in its full meaning. Therefore, this topic has been specified precisely in order to align this chapter, about those displaced from their homelands towards Albania, as well as their settlement in different regions in the Albanian state.

The paper lays out the historical perspective of the reports, status, circumstances and context of the political events that characterize this period, where the Albanians of Kosovo and other countries found themselves in front of the occupying forces, in whose teaching, the violent removal of the Albanians from their lands was concentrated.

In this context, the topic deals with the state political and military plans of the MSKS and Yugoslavia of that time, as well as the goals and strategic actions for the expropriation of Albanians from ethnic territories and the settlement of settlers in these areas in the course of this approach, the paper also reflects the concrete dimensions of the manifestation of violence that the Albanians faced, as direct factors that encouraged their forced departure.

In the first chapter, it deals with the aspect of the factors that have influenced the violent displacement of Albanians from Kosovo. This includes as part of this chapter the first act, which was the occupation of Kosovo in 1918 and also the creation of the Kingdom of Serbs, Croats, and Slovenes, where the authorities immediately began an anti-Albanian policy. Later on, it also portrays the resistance of the Albanian people to the Serbian-Montenegrin rule, where they opposed it with armed resistance against the implementation of this policy known years before. As the last part of this chapter, some administrative and military divisions are presented, including those from 1919 until 1929, where all these divisions had the goal of breaking up the compactness of the Albanian people.

The second chapter encompasses the forced displacement of Albanians from Kosovo to Albania starting from 1918 and continuing until 1924. This is the first stage of the displaced population addressed in this study, where specific research has been conducted to

examine the actions and all the forms of violence employed by Slavic groups against the Albanian population in their territories. Part of this chapter discusses the dispossession of Albanian populations from their properties by the authorities and also the beginning of the so-called agrarian reform, where land was taken from Albanians in the name of this reform, and the same land was given to incoming Serbian and Montenegrin colonists. These actions were escalating day by day, and the life of Albanians became unbearable, as the authorities used every possible means of violence to achieve their goal of displacement and assimilation of Albanians. In this chapter, undoubtedly, the role of the Committee "MKK" holds a significant place. Besides becoming the primary voice of Albanians outside the borders of the Albanian state, it made an extraordinary contribution on the diplomatic front to prevent the displacements. Additionally, it was well-organized to raise awareness among international opinion and the Great Powers about Serbian crimes and massacres against Albanians.

The third chapter deals with the continuation of the implementation of the colonizing agrarian reform and the forced migration of Albanians from Kosovo to Albania during the years 1925-1929, the review of this period and also includes especially the reports of Albanian diplomats on the issue of those displaced from their lands as and the situation in which the Albanians find themselves within the SKS Kingdom.

The fourth chapter deals with the forced displacement of Albanians from Kosovo to Albania during the years 1929-1941, including the latter part of this period until the start of World War II. During this period, the actions of violence by the Yugoslav state apparatus against Albanians to remove them from their lands and establish Slavic settlers intensify even further, along with the implementation of the agrarian reform. Especially in the 1930s, there was a further development of this policy, where many programs, plans, reports, and memoranda were drafted for the displacement of all Albanians from Yugoslavia. This policy was notably championed by the Serbian Cultural Club and, in particular, by figures such as the infamous Vasa Čubrilović and many well-known figures in Serbian science, culture, and politics.

The fifth and final chapter includes the stance of the Albanian State towards the displaced individuals and how successful it was in their resettlement in Albania. After conducting extensive research and findings regarding the displacement of Albanians, this chapter provides an analysis of the approach that the Albanian state followed and its role in relation to the displaced individuals. It also explores how they were settled in Albania, in which areas and regions, and the treatment they received. Additionally, it delves into the measures taken to accommodate the displaced Albanians from their native regions into the

homeland of Albania. The Albanian State, in order to help these new immigrants, managed to draft the legal infrastructure by passing several laws in the 20s, especially the Decree Law on the Settlement of Immigrants from 1931. Also included in the last part of this chapter are completely based on archival documents, statistics throughout these years of displaced and installed Kosovar Albanians in Albania, through various prefectures and regions of the Albanian state, and also the aid given to these immigrants.